

Data 27.01.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje karburanti për nevojat e administratës së bashkisë,
drejtorive dhe sektorëve vartës**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Karburante 09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

16 832 313 (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e trembëdhjetë)
lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor bashkia Gramsh ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare ,ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa vlera e përlllogaritur e kontrates.

Kjo do të vërtetohet duke paraqitur vërtetim për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit lëshuar nga administrata tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues për gatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës"*

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve tre viteve të fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci të kërkuar nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislativës së fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", Ligjin Nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*", të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008" Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (Neni 57), Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 "*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*" i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme ,operatori duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme ,të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës , që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtëm:

- a) Për përvojën e mëparshme me një ent publik duhet të dorëzojë vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit besueshmërinë te Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës

2.3.2 Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht 1(një) stacion të tregëtimit me pakicë të karburantit, brenda territorit të Bashkisë Gramsh,ne nje distance te pershtatshme jo me shume se 10 (dhjete)km nga Zyrat Qendrore te Bashkisë Gramsh , vërtetuar kjo me kontratë noteriale qeraje ose akt pronësie, ose të jenë të pasqyruara në ekstratin tregtar të operatorit ekonomik pjesëmarrës.

Argumentimi:Kerkesa e mesiperme, mbeshtetet me teper ne nje llogjike te qarte dhe te thjeshte, qe konsiston ne faktin qe ; automjeti per t’u furnizuar me karburant, nuk ka pse te pershkoje nje distance , po themi, me teper se 10 km(vajtje-ardhje), duke humbur keshtu kohe dhe gjithashtu duke rritur ne menyre artificiale, jo produktive, konsumin e karburantit

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarres, duhet të paraqesë raport analize nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) për mallin objekt prokurimi, ku vlerat e treguesve të analizuar të perputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; nenit 40 pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe ligjit Nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mund të dorëzojnë dëshmi për rezultate e testime zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë dhe deklaratat si më poshtë:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant me pakicë me shërbim 24 orë, me karta elektronike të personalizuar me targat e automjeteve të autoritetit kontraktor
- Subjekti duhet të deklarojë se kartat elektronike duhet të jetë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Në zbatim të VKM Nr.561 date 29.07.2016 “Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në Njesite të Qeverisjes së Përgjithshme” shërbimi i furnizimit me karburant duhet të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike, e cila mundeson identifikimin e mjetit dhe përdoruesin e saj.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi me pakicë të lëndëve djegëse lëshuar nga Autoriteti Vendor (Bashkia Gramsh) ose Licencë për tregëtimin me shumicë të karburanteve, gazit të lëngshëm naftës për automjete, vajrave lubrifikant, lëshuar nga ministria përkatëse

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë*” nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Ligjit Nr. 8450 date 24.12.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, gazit dhe nënprodukteve të tyre”(të ndryshuar) dhe vkm-së nr.970,datë 02.12.2015,”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës,gazit e nënprodukteve të tyre”,të ndryshuar

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Bashkëlidhur Dst-së